



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:058869  
Datë: 14.12.2023  
Numri i dokumentit: 05066122

**PA1.nr. 124/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Skender Çoçaj, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarve A.Xh. dhe A.Xh.1, që të dy nga fshati..., K. Leposaviç, për shkak te veprës penale ne bashkëkryerje Tregtia e ndaluar nga neni 299 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.Xh.1, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 318/2020 të datës 30.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12 Dhjetor 2023 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit A.Xh.1, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 318/2020 të datës 30.11.2022, **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr. 318/2020 të datës 30.11.2022, të akuzuarit A.Xh. dhe A.Xh.1, janë shpallur fajtorë për shkak te veprës penale ne bashkëkryerje Tregtia e ndaluar nga neni 299 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën të akuzuarit A.Xh. i është shqiptuar dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti me kusht se i njëjti dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari ne afat prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër vepër penale si dhe dënim me gjobe ne shume prej 600 (gjashtëqind) euro e te cilën gjobe eshte obliguar qe ta paguaje pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, ndërsa të akuzuarit A.Xh.1 i është shqiptuar dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti me kusht se i njëjti dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari ne afat prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër

vepër penale si dhe dënim me gjobe ne shume prej 800 (tetëqind) euro e te cilën gjobe është obliguar qe ta paguaje pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin e shqiptuar me gjobe atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet ne dënim me burgim kur për çdo 20 euro te gjobës do t'i llogaritet 1 (një) dite burgim.

Të akuzuarit janë obliguar qe t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale te cilat dalin sipas llogarisë përfundimtare te gjykatës, ne emër te paushallit gjyqësor secili veç e veç shumen prej nga 50 ( pesëdhjetë) euro, si dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit secili veç e veç shumen prej nga 30 ( tridhjetë ) euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit.

Janë konfiskuar ne mënyre te përhershme 4 krerë gjedhe me vlere te përgjithshme prej 2,886.00( dymijë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë) euro

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesave pasurore juridike është udhëzuar ne kontest te rregullt civil.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :**

Mbrojtësi i të akuzuarit A.Xh.1, av.Rexhep Kaçaniku nga Mitrovica, për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, shkeljes se ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim qe aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit A.Xh.1, av.Rexhep Kaçaniku, me shkresën e vet PPA.II.nr. 166/23 të datës 07.02.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit A.Xh.1 ta refuzojë si te pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës se shkalles se pare te vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, ne te cilën nuk prezantuan askush nga palët, andaj seanca e kolegjit u mbajt ne pajtim me nenin 390 paragrafi 4 te KPPRK-se.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te mbrojtësit së të akuzuarit A.Xh.1, dhe gjeti se :

#### **- Ankesa nuk është e bazuar.**

Sa i përket shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit A.Xh.1, me ankese pretendon se aktgjykimi shkalles se pare është i përfshire me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 pika 1.12 e lidhur me nenin 369 pika 2.7 te KPPRK-se, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës mes veti dhe me arsyet e paraqitura ne arsyetimin e aktgjykimit dhe me shkresat e lendes. Pretendon se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës dhe i

pakuftueshëm me brendinë e tij dhe arsyet e aktgjykimit. Gjithashtu, pretendon se Gjykata e shkalles se pare ne aktgjykimin e kundërshtuar nuk ka paraqitur arsyet për secilën pike veç e veç, nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e mbrojtjes në këtë çështje penale dhe nuk ka përshkruar veprimet inkriminuese së të akuzuarit duke mos i specifikuar te njejtat, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar. Gjithashtu pretendon se i akuzuari nuk e njih gjuhen shqipe dhe i njëjti është shprehur përmes përkthyesit gjuhësor, andaj edhe aktgjykimi është dashur qe te t'i dorëzohet ne gjuhën serbe ne pajtim me nenin 14 par.5 të KPPRK-së. E gjithashtu edhe procesverbalet mbi kontrollin inspektues janë përpiluar ne gjuhen shqipe.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit së të akuzuarit A.Xh.1 lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare është i qarte dhe i kuptueshëm dhe si i tille përmban arsye te mjaftueshme përkitazi me faktet relevante te kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga te cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave te ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura ne ankese nuk janë te natyrës se tille për te konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi te atilla procedurale qe do ta bënin te paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. S i përket pretendimit ankimor se vendimet dhe parashtrësat janë përpiluar ne gjuhen shqipe sipas Gjykatës se Apelit kjo nuk ndikon ne ligjshmërinë e aktgjykimit ngase nga shkresat e lendes shihet se ne çdo seance para gjykatës se shkalles se pare ka prezantuar përkthyesi gjuhësor dhe se aktgjykimi i është dorëzuar edhe mbrojtësit se te akuzuarit i cili e ka për detyre që për çdo shkresë te njoftoj edhe te akuzuarin dhe te konsultohet me te njëjtin, andaj Gjykata e Apelit i refuzoi pretendimet ankimore i refuzoi si te pabazuara.

Sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit A.Xh.1 pretendon se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes se ligjit penal ne dem së të akuzuarit ka ardhur deri te vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, siç është pretenduar në aktakuzë e që këto fakte nuk janë vërtetuar as pas administrimit të provave dhe dëgjimit të dëshmitarëve andaj gjykata sipas mbrojtësit të akuzuarin e ka shpallur fajtor pa u plotësuar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar ngase kafshët e transportuara kanë prejardhje, kanë pasaporta dhe më parë kanë qenë pronë e dëshmitarëve Z.I., A.S., e M.S., pra, këto kafshë kanë qenë të furnizuara me dokumentacion valid e jo siç ka konstatuar gjykata e shkalles se pare se të akuzuarit pa autorizim kinse kane blere me qëllim shitje 4 krerë bagëti të racave te ndryshme pa dokumentacion përkatës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit së të akuzuarit A.Xh.1, lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase janë ne kundërshtim me provat e administruara si dëgjimin e dëshmitareve B.B., N.R., A.B., S.I., Q.M., nga deklaratat e te cilëve eshte vërtetuar malli i konfiskuar nuk ka prejardhje dhe se ne kamionin e ndalur te cilin e kane drejtuar te akuzuarit kane qene 4 krerë kafshë dhe te njëjtit nuk kane pasur dokumentacion për realizimin e tregtisë, pastaj gjatë kontrollimit të të njëjtave është konstatuar se ne vrimat e veshëve ka qenë gjak i freskët dhe se ato matrikula ishin vendosur para pak çasteve dhe se kafshët nuk kane pasur matrikula te veta personale por figuronin ne emër te pronarëve te tjerë e gjithashtu edhe 2 certifikata shëndetësore te kafshëve ishin me afat te skaduar për çka edhe kafshët janë konfiskuar dhe dërguar ne terminalin doganor dhe posa që i kane prekur kafshët ne qafë vathët iu kane rënë në tokë, andaj edhe pretendimet

ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike i refuzoi si te pabazuara si dhe konstatoi se ne rastin konkret kur i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, për çka është pretendimet e mbrojtësit lidhur me shkeljen e ligjit penal në dëm të së akuzuarit i refuzoi si të pabazuara ngase ne veprimet e te akuzuarës ekzistojnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive te veprës penale Tregtia e ndaluar nga neni 299 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit, me ankesë pretendon se gjykata e shkalles se pare është dashur qe të akuzuarin ta liroj nga akuza, megjithatë Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe ne këtë aspekt lidhur me këtë bazë ankimore.

Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së e te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit duke vërtetuar aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare e me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.124/23 më 12.12.2023**

**Procesmbajtës**  
**Arben Arifi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit**  
**Zyhdi Haziri**

---

**Skender Çoçaj**

---